

Sipas ligjit 78/2014 ‘‘Për organizimin dhe funksionimin e QBZ-së’’

Qendra e Botimeve Zyrtare është përgjegjëse për:

1. botimin e akteve të botueshme, të cilat dërgohen në këtë Qendër;
2. botimin në formë të shtypur të kodeve të përditësuara dhe të përmbledhësve të legjislacionit, sipas tematikës;
3. Botimin , publikimin dhe shitjen e Fletorez zyrtare , Kodeve dhe Përmbledhësve .
3. Mirëmbajtjen dhe garantimin e mirëfunksionimit të Arkivit Elektronik të Akteve dhe të faqes zyrtare të internetit;
4. Qbz mundëson informacion ligjor për publikun rreth akteve të botuara në Fletoren Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, sipas Ligjit 119/2014 ‘‘Për të drejtën e informimit’’ ETJ...

TARIFAT NE QBZ

SIPAS LIGJIT 119/ 2014 ‘Për të drejtën e informimit’

Neni 13

Kostoja e shërbimit

1. Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas.
2. Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg.
3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shqyrton periodikisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, tarifat e bëra publike nga autoritetet publike dhe, sipas rastit, urdhëron ndryshimin e tyre.
4. Qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, e përfitojnë informacionin falas deri në një numër të caktuar faqesh për çdo kërkesë ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër.
5. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave me udhëzim të përbashkët përcaktojnë numrin e faqeve, për të cilat informacioni përfitohet falas, sipas pikës 4, të këtij neni, si dhe rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 8451/4, datë 5.1.2015

PËR ÇAKTIMIN E ÇMIMIT DHE TARIFAVE TË BOTIMEVE TË QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE, SI DHE INSTITUCIONET QË PËRFITOJNË FALAS KOPJE TË BOTUARA TË FLETORES ZYRTARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 16, pika 4, të ligjit nr.78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Çmimi i shitjes së botimeve (përfshirë edhe Fletoren Zyrtare) llogaritet si prodhim i çmimit për një faqe, me numrin e faqeve të botimit. Çmimi për një faqe është 7 (shtatë) lekë.
2. Për botimet me lidhje speciale, çmim total i botimit do të jetë i barabartë me çmimin e rezultatit të prodhimit (7 lekë për nr. faqesh) plus 300 lekë.
3. Çdo subjekt i interesuar mund të bëjë abonim vjetor pranë “Posta Shqiptare” sh.a.
4. Botimet (përfshirë edhe Fletoren Zyrtare) mund të shiten drejtpërdrejt nga Qendra Botimeve Zyrtare me çmimin e vendosur në kapak. Pagesa bëhet në llogarinë bankare zyrtare të Qendrës.
5. Çmimi i abonimit vjetor pranë “Posta Shqiptare” sh.a., për Fletoren Zyrtare, është 20 000 (njëzet mijë) lekë.
6. Çmimi i shitjes së botimeve për libraritë dhe agjencitë shpërndarëse llogaritet me një zbritje prej 5% mbi çmimin e llogaritur sipas pikës 1, të këtij urdhri (kur ky aktivitet pasqyrohet në objektin e aktivitetit tregtar të këtij subjekti tregtar).
7. Çmimi i shitjes së serive të Fletoreve Zyrtare në CD-ROM për secilin vit, është 5000 (pesë mijë) lekë.
8. Konsultimi i akteve të botuara në Fletoren Zyrtare në faqen zyrtare të internetit është falas.
9. Për konfirmimet dhe kopjet e akteve të caktuara, do të zbatohet çmimi 20 (njëzet) lekë për fletë.
10. Për shumëfishime të Fletores Zyrtare të numrave të kaluar, jashtë tirazhit të përcaktuar, do të zbatohet çmimi 20 (njëzet) lekë për faqe.
11. Shpërndarja e Fletores Zyrtare, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet me kontratë me “Posta Shqiptare” sh.a., e cila mban 10% të vlerës së abonimit.
12. Institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare, janë ato të përcaktuara sipas ligjeve të posaçme.
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

NR.	TITULLI I BOTIMIT	VITI I BOTIMIT	CMIMI
1.	KUSHTETUTA E RSH-së	2018	8,460
2.	Përmbledhëse legjislacioni për të drejtën e informimit	2017	2,492.00
3.	Përmbledhëse legjislacioni për arsimin	2017	2,996.00
4.	Përmbledhëse legjislacioni për Sigurimet Shoqërore	2017	2,632.00
5.	Përmbledhëse Legjislacioni për Koncensionet	2018	1,092.00
6.	Përmbledhëse legjislacioni për Vetqeverisjen Vendore dhe Reformën Administrative	2018	4,312.00
7.	Përmbledhëse Legjislacioni për Pasuritë e Paluajtshme dhe Trojet	2018	2,996.00
8.	Përmbledhëse Legjislacioni për Noterinë	2018	602
9.	Përmbledhëse Legjislacioni për Legalizimet	2018	588
10.	Përmbledhëse Legjislacioni për Koncensionet	2018	1,092.00
11.	Dispozita Zbatuese të Kodit Doganor	2018	6,986.00
12.	Përmbledhëse Legjislacioni në Fushën e Drejtësisë	2018	3,934.00
13.	Përmbledhëse Legjislacioni në fushën e Drejtësisë Penale	2018	4,074.00
14.	Përmbledhëse legjislacioni për Përmbartimin	2018	644
15.	Përmbledhëse Legjislacioni për Shërbimet Publike	2019	910
16.	Përmbledhëse Legjislacioni për Investimet	2019	406
17.	Përmbledhëse Legjislacioni për Urbanistikën	2019	2,506.00
18.	Kodizgjedhor	2017	2,022.00
19.	Kodi Rrugor	2018	2,176.00
20.	Kodi Doganor	2018	2,008.00

21.	Kodi Penal, Penal Ushtarak	2018	2,540.00
22.	Kodi Ajror	2018	308
23.	Kodi i Familjes	2019	1,112.00
24.	Kodi I procedurës administrative	2019	1028
25.	Kodi I procedures civile	2019	1966
26.	Kodi civil	2019	3290
27.	Vendimeunifikuese të gjykatësëlartë	2019	2520
28.	Kodi I punës	2019	1336
29.	Kodihekurudhor	2019	1336
30.	Kodidetar	2019	1616
31.	Kodi penal	2019	1896
32.	Kodi I procedures penale	2019	2736
33.	KONVENTA për të drejtat e njeriut	2020	304
34.	Përmbledhëse për personat me aftësi të kufizuar	2020	1144
35.	Përmbledhëse për tregtine , titujt financiarë	2020	1152
36.	Përmbledhëse për mediat	2020	584
37.	Përmbledhëse për teknologjinë e informacionit dhe komunikimet elektronike	2020	808
38.	Përmbledhëse për punësimin	2020	1328
39.	Përmbledhëse për bujqësinë	2020	1440
40.	Përmbledhëse për ndërtimet	2020	1616
41.	Vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë	2020	1440
42.	Kushtetuta e RSH-së	2020	730

43.	Kodi civil	2020	1690
44.	Kodi I procedures civile	2020	1194
45.	Kodi I procedures penale	2020	1626
16.	Kodi I familjes	2020	690
47.	Kodi I punës	2020	842
48.	Kodi I procedures administrative	2020	650